



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:900422

Datë: 06.08.2024

Numri i dokumentit: 06021630

CAP.nr.208/23

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil me gjyqtarin individual Adnan Konushevci, në çështjen përmbartimore të kreditorit Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) sh.a, me seli në Prishtinë, Rruga “Nënë Tereza”, nr.36, ndaj debitorës F.B nga P....., Rruga “Petro Marko”, Nr.44/17, me bazë juridike borxh në shumë prej 2,386.41 euro, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, të ushtruar kundër aktvendimit PPP.nr.286/19 i datës 28.05.2020, të Gjykatës Themelore në Prishtinë, me datë 06.08.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e debitorës F.B nga P....., Rruga “Petro Marko”, Nr.44/17, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, PPP.nr.286/19 i datës 28.05.2020, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë, me aktvendimin e atakuar PPP.nr.286/19 të datës 28.05.2020, ka vendosur si në vijim: *“I.REFUZOHET i pabazuar prapësimi i debitorit F.B nga P....., i ushtruar kundër urdhrit për lejimin e përmbartimit P.nr.2626/18 i datës 19.12.2018, të lejuar nga Zyra Përmbartimore-Përmbartuesit Privat RR.M në Prishtinë. II. Në rast se debitori parashtron ankesë kundër këtij aktvendimi Urdhërohet që në afatin prej 7 (shtatë) ditësh të paguaj garancinë në gjykatë në shumë prej 2,386.41Euro. III. Nëse debitori dështon të paguaj shumën e garancisë brenda afatit të caktuar, ankesa e ushtruar kundër këtij aktvendimi, do të konsiderohet se nuk është dorëzuar fare nga pala ankuese”.*

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitorja, për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të se drejtës materiale, me propozim që të aprovet ankesa e debitorës dhe të anulohet aktvendimin i goditur më ankesë ndërsa urdhri për përmbartim të shfuqizohet.

Kreditori nuk ka paraqitur përgjigje në ankesë.

Gjyqtari individual i Gjykatës së Apelit, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

-Ankesa është e pathemeltë

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori ka paraqitur propozim për përmbartim ndaj debitorës në bazë të dokumentit të besueshëm-ekstraktit të verifikuar nga librat afarist për pagesat e shërbimeve komunale për energji elektrike, DPR – 206111 i datës 18.12.2018, në shumën prej 2,386.41 euro, për periudhën 13.01.2008 deri me 20.03.2013. Përmbartuesi privat ka lejuar përmbartimin me urdhrin P.nr.2626/18 i datës 19.12.2018, ndaj të cilit urdhër debitori ka ushtruar prapësim me datën 28.12.2018, ndërsa kreditori me datën 11.01.2019, ka paraqitur përgjigje në prapësim. Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin PPP.nr.286/19 të datës 28.05.2020, ka refuzuar në tersi si të pa bazuar prapësimin e debitorës, duke e urdhëruar debitorin që të bënë edhe pagesën e garancionit në shumën prej 2,386.41 euro, sa edhe është shuma e kërkuara e borxhit. Mirëpo pas kërkesës për lirim nga garancioni më të drejtë gjykata e shkallës së parë merr aktvendim PPP.286/2019 të datës 10.03.2021, ashtu që në pikën -II-, të dispozitivit të aktvendimit të lartcekur e zbrit lartësinë e pagesës së garancionit, dhe atë detyrohet debitorja që në emër të garancionit të bënë deponimin – pagesën në shumën prej 1,000.00 euro, konform këtij aktvendimi debitorja e k bërë deponimin e garancionit në shumën prej 1,000.00 euro, siç konstatohet nga urdhër pagesa e datës 20.04.2021, që siç e ka theksuar gjykata e shkallës së parë është kusht ligjor për procedimin e mëtejme të ankesës.

Gjykata e Apelit, vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjenden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata e Apelit, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Duke marr parasysh se në rastin konkret kemi të bëjmë me propozim për përmbartim, në bazë të dokumentit të besueshëm ku me dispozitën e nenit 29 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore nr.04/L-139, përcaktohet se përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet në bazë të dokumentit të besueshëm dhe se dokument i besueshëm sipas LPP-së është: ekstrakti i verifikuar nga librat afarist për pagesat e shërbimeve komunale. Dokumenti i besueshëm, është

i përshtatshëm për përmbarim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar, e në rastin konkret kemi të bëjmë me dokument të besueshëm siç ekstrakti DPR-206111 , në shumën e kërkuar për pagesë prej 2,386.41 euro. Ekstrakti është i përshtatshëm për përmbarim ngase është dorëzuar në origjinal, në të është cekur kreditori dhe debitori, objekti, lloji dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar, andaj, nga kjo rezulton se dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim dhe se gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka vepruar kur ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit.

Sipas dispozitës së nenit 368, paragrafi 1 dhe 2 të LMD-së: përcaktohet se: *“Parashkrimi ndërpritet kur debitori e pranon borxhin dhe se pranimi i borxhit mund të bëhet jo vetëm me deklaratën e kreditorit, veçse edhe në mënyrë të tërthortë, sikurse janë pagesa e këstit, pagesa e kamatës, dhënia e sigurimit”*, ashtu që në rastin konkret debitorja ka bërë pagesa të cilat kanë ndikuar në ndërprerjen e parashkrimit dhe se i njëjta ka lidhur kontratë për pagesën e borxhit me dhe deklaratë mbi dakordimin e borxhit, me Nr. 40317 e datës 30.08.2016, me çka është bërë edhe pranimi i borxhit nga ana e debitores.

Pretendimi ankimor i debitores së borxhi është përfshirë në parashkrim, dhe gjykata e shkallës së parë nuk e ka marr parasysh më rastin e vendosjes është i paqëndrueshëm sepse edhe kjo gjykatë vlerëson se debitorja më vullnetin e saj, e ka lidhur kontratë për pagesën e borxhit, dhe e ka nënshkruar deklaratën mbi dakordimin e borxhit, me Nr. 40317 e datës 30.08.2016, si dhe ka bërë pagesa sipas kontratës së lartcekur dhe marrëveshjes për dakordim e borxhit, sipas programit të pagesës së borxhit, deri më datën 20.03.2018, ndërsa urdhri për përmbarim është lejuara me datë 19.12.2018, që rezulton në këtë rast se është ndërprerë afati i parashkrimit, ashtu siç është vlerësuar më të drejtë edhe nga gjykata e shkallës së parë. Për më tepër Gjykata e Apelit vlerëson se debitorja me kreditorin ashtu siç u theksua më lart kanë arritur marrëveshje që të bëhet pagesa e borxhit në shumë prej 792.12 euro, në 18 këste, sipas programit të pagesës së borxhit, me qëllim që debitorja të përfitojë nga Ligji për faljen e borxhit, të grumbulluar deri më datë 31.12.2008, në shumë prej 1,864.20 euro, ku sipas nenit 3 të kontratës është përcaktuar se: *“Në rast se përfituesi shkakton 3 pagesa të njëpasnjëshme lidhur me pagesat sipas Programit, marrëveshja shkapëputet dhe pjesa e pa paguar e borxhit, nëse ka, fshihet dhe pjesa e mbetur e borxhit i rikthehet, përfshirë këtu edhe të gjitha ndëshkimet”*. Në rastin konkret debitorja me datë 30.08.2016, ka lidhë kontratë për pagesën e borxhit dhe deklaratën për dakordimin e borxhit me kreditorit, kurse me datën 20.03.2018, ka bërë pagesën e energjisë kësti i 6, dhe pastaj e ka ndërpre pagesën duke mos ju përmbajtur kontratës në fjalë, Andaj, në rastin konkret debitorja nuk i është përmbajtur marrëveshjes dhe kreditori i ka rikthyer të njëjtit të gjithë borxhin e vjetër,

duke i zbritur vlerën e pagesave të bëra, ashtu që kreditori ka kërkuar borxhin si në propozimin për përmbarim. Nga të cekurat kjo gjykatë vlerësoj se aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë duhet vërtetuar dhe të refuzohet ankesa e debitorës si e pathemeltë.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 209, pika b), të LPK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.208/2023 me datë 06.08.2024

Gjyqtari
Adnan Konushevci